Republika e Kosovës
Republika Kosova — Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opstina Priitina —Municipality of Prishtina

PRISHTINA

DREJTORIA E ARSIMIT
Nr. 14-111/01-0172025/26
Data: 20.11.2026

Bazuar në nenin 8, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90/2010), nenin 5, paragrafi c, të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimin Administrativ nr. 05/2015, Udhëzimin Administrativ nr. 05/2021 dhe Rregulloren (QRK) nr. 19/2024 për rregullimin e procedurave të përzgjedhjes së drejtorëve, zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve dhe sekretarëve në IEAA, Komuna e Prishtinës shpall:

KONKURS
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Nr.	Niveli	Titulli i vendit të punës	Vend i lirë/Zëvendësim	Nr. i pozitave	Koeficienti i pagës
1	SHFMU	Mësimdhënës/e për Matematikë	Vend i lirë	2	6.6
2	SHML	Mësimdhënës/e për Matematikë	Zëvendësim	1	6.8
3	SHFMU	Mësimdhënës/e për Kimi	Vend i lirë	1	6.6
4	SHML	Mësimdhënës/e për Kimi	Zëvendësim	1	6.8
5	SHFMU	Mësimdhënës/e për TIK	Vend i lirë	1	6.6
6	SHFMU	Mësimdhënës/e për TIK	Zëvendësim	1	6.6
7	SHML	Mësimdhënës/e për Violonçelo	Vend i lirë	1	6.8

I. **Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:**

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në KK Prishtinë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokument identifikimi kopje (letërnjoftim ose pasaportë valide);
- Diplomat e kualifikimit të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga MASHTI;
- Certifikatën shëndetësore, të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor, me të cilin dëshmohet gjendja shëndetësore;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës së punës në institucionet edukative arsimore (nëse ka);
- **Diplomat e noterizuara dhe Certifikata mjekësore duhet të sillen me rastin e nënshkrimit të kontratës;**

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Matematikë:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Kimi:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Teknologji informative:

Programi/dega Teknologji- informatikë

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Violonçelo

- Master i muzikës - (studimet e kompletuara për instrumentin përkatës);

- **Detyrat dhe përgjegjësitë e mësimdhënësit**

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj/të punës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri;
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi, barazi dhe pa dallime me bashkëpunëtorët të cilët punon;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi;
- Të mos kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç drejtorit të shkollës dhe DKA-së;
- Të mos e shfrytëzojë pozitën e punës për interesa private në dobi të ndonjë pale të tretë, përfshirë edhe familjen, shoqërinë apo miqësinë e tij;
- Të ushtrojë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës. Përfshirë, ruajtjen e informatave (nëse nuk janë publike), të cilat lidhen me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik dhe juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të detyrave apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton.
- Të mbaj orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.
- I punësuari është i obligiuar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore.
- I punësuari nuk do të kryejë punë apo detyrë tjetër, me orar të plotë, nëse puna e tillë, bie ndesh me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga DKA-ja ose përfaqësuesit të saj.
- Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve, sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës;
- Punë dhe detyra të tjera shtesë të caktuara nga drejtori i shkollës dhe detyra të përcaktuara në legjislacionin në fuqi të arsimit parauniversitar.

Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 7 ditë nga data e publikimit të konkursit **20.11.2026** deri më datën **26.11.2026.**
- Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës dhe në https://prishtinaonline.com ;
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje,
- **Nëse aplikohet për pozitën e njëjtë, vend i lirë/Zëvendësim, në të njëjtin institucion, kandidatët duhet të dorëzojnë vetëm një (1) aplikacion;**
- **Ndërsa, nëse aplikohet për pozitën e njëjtë, vend i lirë/zëvendësim, në institucione të ndryshme, kandidatët duhet të dorëzojnë dy (2) aplikacione; p.sh. një (1) aplikacion për SHFMU dhe (1) një aplikacion për SHML**
- **Kandidatët të cilët gjatë procesit të vlerësimit, vlerësohen me pikë më të larta sistemohen në vendet e lira, ndërsa për pozitat zëvendësim, sistemohen kandidatët me pikë më të ulëta.**
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit (numrin e protokollit), e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);

Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit të stafit arsimor për vitin shkollor 2026/2027;
- Kandidatët me kualifikime jo-përkatëse sipas legjislacionit në fuqi nuk do të merren në shqyrtim;
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kritereve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim;
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm;
- Pikët e mbledhura në fazat vlerësuese renditin kandidatët me më shumë pikë që do të përzgjidhen në pozitat e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim, intervistë me gojë, si dhe rezultatet përfundimtare publikohen në webfaqen e Komunës së Prishtinës https://prishtina.rks-gov.net/ dhe https://prishtinaonline.com (konkurset)
- Në rast të ndonjë nevoje eventuale për plotësim të pozitave (vendeve) të lira/zëvendësime në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave të publikuara me rastin e shpalljes së rezultateve, e cila konsiderohet si listë pritëse;
- Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë bëhet në varësi të lirimit real të vendit të punës (datës së pensionimit, pushimit të lehonisë, etj).
- Anëtarët e komuniteteve joshumicë dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohen të aplikojnë në pozitat e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, plotësimi jo i saktë dhe jo i qartë i formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.